

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

“ 4 E - COLOR “ SHPK



Ne baze te ligjit, nr 7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare" si dhe te ligjit, nr 7667, date 28.1.1993, " Per Rregjistrin Tregtar ", ne te nenshkruarit Skender Aga, Erion Cumashi dhe Elsi Pecani, shpallin si me poshte vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur " 4 E – COLOR “ SHPK, me ortakët e meposhtem :

- 1- Z.Skender Aga, lindur ne Durres ne 23.11.1955, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me shtetesi shqiptare, me nr pashaporte 1686312.
- 2- Z.Erion Cumashi, lindur ne Durres, ne 12.9.1973, banues ne Tirane, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me shtetesi shqiptare, me numur leternjoftimi QH 346688.
- 3- Z.Elsi Pecani, lindur ne Tirane, ne 1.2.1983, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me shtetesi shqiptare, me nr pasaporte 0012289.

QENDRA E SHOQERISE

Neni 2

Qendra e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes ne adresen " Fadil Rada, nr 78 ”.

Shoqeria mund te hape filiale dhe zyra ne te gjithe territorin e Shqiperise me miratimin e Asamblese se Ortakeve dhe ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

Shqiperise me miratimin e Asamblese se Ortakeve dhe ne perputhje me kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 20 vjet.Ajo mund te zgjatet me pelqimin e ortakeve. .

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4


Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Tregetimi me shumice dhe pakice,import eksport,i lendeve te para,materjaleve ndimhese,makineri,paisje,pjese kembimi,per veprimtari shtypi.
- Tregetim me shumice dhe pakice,import eksport,i materjaleve kancelarike.
- Prodhim dhe shitje shtypshkrimesh,libra,gazeta,fletore, postera,flete palosje etj.
- Tregetim mallrash industriale,me shumice dhe pakice,import eksport.

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin, simbas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

KAPITALI I SHOQERISE



Neni 6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke, dhe ky kapital eshte vene ne masen :

Z.Skender Aga 51.000 leke ose 51 % e kapitalit themeltar.

Z.Erion Cumashi 24.500 leke ose 24.5 % e kapitalit themeltar.

Z.Elsi Pecani 24.500 leke ose 24.5 % e kapitalit themeltar.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise jane vetem per pjesen e kapitalit te derdhur nga ai. Per detyrimet e tjera te shoqerise anetari nuk mban pergjegjesi.

Kapitali i shoqerise eshte teresisht i shlyshem dhe i neneshkrushem nga ortaket themelues.

Neni 7

Shoqeria drejtohet nga Asambleja e Ortakeve, simbas rregullave te percaktuara ne ligje dhe ne Statut.

Administrator i shoqerise eshte Z.Erion Cumashi, i cili do te kryeje te gjitha veprimet qe jane te lejuara nga ligji dhe te percaktuara ne Statutin e shoqerise


Neni 8

Viti i pare financiar mbyllet me 31 Dhjetor te vitit 2002.

Neni 9

Te gjitha mosmareveshjet midis ortakeve,te cilat nuk zgjidhen me mirekuptim,i paraqiten per shqyrtim dhe zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Akti i themelimit perpilohet ne disa kopje per tju shperndare organeve kompetente,ndersa nje kopje mbetet pjese perberese e dokumentacionit te " 4 E – COLOR " SHPK.



Tirane me 2.2.2002

ORTAKET THEMELUES

Skender Aga

Skender Aga
Skender

Erion Cumashi

Erion Cumashi
Erion

Elsi Pecani

ELSI PECANI
Elsi

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE**


Nr 722 Rep.
82 Kol

VERTETIM

Sot ne date, 2.2.2002, para meje noteres u paraqiten personalisht :


Z.Skender Isa Aga, Z.Erion Mitrush Cumashi, Z.Elsi Agron Pecani,
me identitet te verifikuar, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te
vepruar, te cilet me deklaruan se sa siper eshte akti i themelimit te “ 4 E –
COLOR “ SHPK, i perpiluar, me vullnet te lire, prej tyre, te cilin e
neneshkruan pa verejtje dhe une e vertetoj simbas ligjit.

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI, P.2. AP. 21
TIRANE
TEL. 2 98 32



STATUTI I SHOQERISE

“4 E – COLOR” SHPK



Ne baze te ligjit nr 7638, date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare”, ligjit nr 7667, date 28.1.1993, “Per Regjistrin Tregtar”, dhe aktit te themelimit date 18.2.2002, ne të nënshkruarit u morem vesh per krijimin e shoqerise si me poshte :

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur “4 E - COLOR” SHPK, me ortake:

1-Z. Skender Aga, i biri i Isait, lindur me 23.11.1955, në Durrës, banues ne Tirane, ne adresen Rruga e Elbasanit, nr 45, me nr pasaporte 1686312, madhor, me shtetesi shqiptare, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

2-Z. Erion Cumashi, i biri i Mitrushit, lindur më 12.9.19973, ne Durrës, banues ne Tirane, në adresën Rruga Naim Frasheri, pallati 84, shkalla 1, apartamenti 10, me nr. leternjoftimi QH 346688, madhor, me shtetesi shqiptare, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

3- Z. Elsi Pecani, i biri i Agronit, lindur më 1.2.1983, ne Tirane, banues ne Tirane, në adresën Rruga e Kavajes, oborri i NPV, shkalla 1, apartamenti 10, me nr pasaporte 0012289, madhor, me shtetesi shqiptare, me zotësi të plotë juridike dhe për te vepruar

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, ne adresen Rruga Fadil Rada, nr 78.

Transferimi i selise se shoqerise ne nje adrese tjeter behet me

Fadil Rada, nr 78.

Transferimi i selise se shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e ortakeve.

Shoqeria mund te hape filiale apo zyra te saj ne te gjithe teritorin e Shqiperise.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është 20 vjet dhe fillon prej datës së regjistrimit, në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet me miratim te ortakeve.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Tregtimi me shumice dhe pakice,import eksport,i lendeve te para,materjaleve ndihmese,makineri,pajsje,pjese kembimi,per veprimtari shtypi.
- Tregtimi me shumice dhe pakice,import eksport,i materjaleve kancelerike.
- Prodhim dhe shitje shtypshkrimesh,libra,gazeta,fletore, postera,flete palosje etj.
- Tregetim mallrash industriale,me shumice dhe pakice,import eksport.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital eshte paguar ne masën 100 % dhe ndahet, perkatesisht :

- Z. Skender Aga 51.000 leke ose 51 % , te kapitalit themeltar,
- Z. Erion Cumashi 24.500 leke ose 24.5 % , te kapitalit themeltar.
- Z. Elsi Pecani 24. 500 leke ose 24.5 % ,te kapitalit themeltar..



Kapital themeltar i shoqerise mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimeve te Asamblese se Ortakeve.

Ne rast shtese te kapitalit themeltar, nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortaket kane te drejten e perparise ne nenshkrim proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre. Cdo ortak nuk kufizohet ne drejtim te ritjes se pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj.

Zvogelimi i kapitalit vendoset nga ortaket me mirekuptim. Ne rast te kunder vendoset simbas propozimit te ortakut qe ka me shume se $\frac{1}{2}$ e vleres se kapitalit themeltar.

Pakesimi i kapitalit ndikon tek te gjitha ortaket ne te njejten mase.

Kapitali i shoqerise eshte teresisht i shlyeshem dhe i neneshkrueshem nga ortaket themelues.

LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Neni 6

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme ndermjet ortakeve, ne rruge trashegimie, ne rast te ndarjes se pasurise ndermjet bashkeshorteve, ndermjet te lindurve dhe te paslindurve.

Kur nje nga ortaket do te shese pjeset e kapitalit te tij me perpara ate duhet tia ofroje ortakeve te tjere. Ne rast se ortakët nuk pranojne ta blejne ate here ai pjesen e tij te kapitalit ka te drejte tua shese te treteve, por jo me cmim me te ulet se ai qe ju kishte propozuar ortakeve.

Fitimet e shoqerise ju perkasin ortakeve themelues ne raport me pjesen qe secili ka ne kapitalin themeltar.

Ortakët e shoqerise i perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit ne kapitalin themeltar.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

Cdo ortak ka te drejte vote te barabarte me pjesen qe zoteron ne kapitalin themeltar.

Ne ushtrimin e te drejtes se tyre per te mare pjese ne vendim cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet, me akt te shkruar prej tij, nga nje person tjeter ose me avokat.

Organi kryesor qe drejton aktivitetin e shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja e Ortakeve mund te thiret nga secili ortak, nga

administratori, ekspertit kontabel i autorizuar apo nga likuidatori.

Simbas rendesise se vendimeve, Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakoneshme ose e jashtezakoneshme.

Asambleja e zakoneshme e ortakeve vendos per ceshtje te tilla si emerimi apo shkarkimi i administratorit, ekspertit kontabel te autorizuar dhe likuidatorit, miratimi i raporteve te administrimit dhe te kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarja e fitimit etj.

Asambleja e jashtezakoneshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimi i statutit, pakesimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja ose shkurtimi i kohes se veprimtarise se shoqerise etj.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve si rregull meren me mirekuptimin e ortakeve. Kur kjo nuk arihet vendos ortaku apo ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e kapitalit themeltar.

Neni 8

Shoqeria administrohet nga nje administrator.

Administratori vepron ne emer dhe per interes te shoqerise, nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me ligjin dhe kete statut. Administratori nuk mund te kryeje veprime te cilat ligji dhe ky statut i ka lene ne kompetence te ortakeve.

Administratori ka te drejte qe per kryerjen e disa detyrave te caktoje me akt perfaqesimi persona te tjere.

Administrator i shoqerise eshte Erion Cumashi.

Neni 9

Kontrrolli financiar i shoqerise kryhet nga eksperti kontabel i autorizuar, i caktuar nga Asambleja e Ortakeve.

Eksperti kontabel i autorizuar shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve kur ne punen e tij verehen te meta ose kur ai eshte ne kushte qe nuk mund te kryeje detyren e caktuar.

Neni 10

Emertimi i shoqerise si dhe emri i administratorit duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakoneshme dhe me permbajtjen perreth saj.



Neni 11

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper vete te gjitha te drejatat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te saj si dhe pergjigjen per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve.

Neni 12

Marja e vendimeve nga Asambleja, mbajtja e proces verbalet dhe e te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen simbas ligjit.

MARDHENIET E PUNES

Neni 13

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes, bazuar ne legjislacionin ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoj rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre te kunderligjeshme..

Neni 14

Konsiderohen si sekrete te punes te gjitha aktet dhe dokumentat qe jane vendosur si te tilla nga Asambleja dhe administratori i shoqerise.

Neni 15

Viti financiar fillon me 1 Jenar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel, miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

Per ceshtjet qe ortaket kane mendim te kundert vendoset simbas mendimit te ortakut apo ortakeve qe kane me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave per veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati deri ne 6 muaj, nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 16

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe nxjerjen e rezultatit ekonomik, fitim, humbje dhe inventar. Pas vecimit te fondeve si me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, te ardhurat qe mbesin ndahen midis ortakeve, ne proporcion me pjeset e tyre ne kapitalin e shoqerise.

Neni 17

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin, brenda 4 muajve, likuidimin e shoqerise.

Neni 18

Ne rast se shoqeria shperndahe, per cdo lloj arsye, Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per cregjistrimin e saj nga Rregjistri Tregtar.


DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 19

Persa eshte shprehur ne kete statut bazohet ne ligjin 7638 dt 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare", Statutit dhe rregullores se brendeshme te shoqerise.

Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte vepruar dhe me kete Statut por pa prekur personalitetin juridik te shoqerise.

Neni 20



Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e shoqerise.


Tirane me .2.2002

ORTAKET


Skender Aga



Erion Cumashi



Elsi Pecani



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE

Nr...*711...Rep*
82 tel

VERTETIM

Sot, ne date *2.2.2002*, para meje noteres *Tamara Malaj*^u paraqiten personalisht :

1-Skender Aga,i biri i Isait,lindur ne Durres,ne 23.11.1955,banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me nr pashaporte 1686312.

2-Erion Cumashi,i bir i Mitrushit,lindur ne Durres,ne 12.9.1973,banues ne Tirane,madhor,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,me numur leternjoftimi QH 346688.

3- Elsi Pecani,i biri i Agronit,lindur ne Tirane,ne 1.2.1983,banues ne Tirane,mnadhhor,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,me nr pasaporte 0012289,.

te cilet me deklaruan se Statuti i shoqerise " 4 E - COLOR " SHPK,eshte perpiluar dhe firmosur rregullisht prej tyre dhe une e vertetoj simbas ligjit.

NOTERE **100 LLE TAKSE**

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI, B.D. AP. 21
TIRANE
TEL. 2 98 32

100
LEKE
R-SHQIPERISE